



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Periudha raportuese	Shkurt 2016
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Habib Qorri, shef i sektorit

#### **1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

- Gjatë muajit raportues, shkurt 2016, janë realizuar të gjitha detyrat e planifikuara nga zyrtarët e Drejtorisë.

#### **2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.**

Punët të cilat kanë vazhduar të mbikëqyren nga viti i kaluar, janë: Planifikimi i detyrave dhe aktiviteteve të Sektorit për mbrojtje e shpëtim për vitin 2016:

1. Mirëmbajtja e ndriçimit publik për vitet 2015-2016, në 3 loto;
2. Zgjerimi i ndriçimit publik për vitet 2015-2016;
3. Mirëmbajtja e fontanave;
4. Mirëmbajtja e semaforëve;
5. Ndërtimi i semaforëve dhe radarëve statikë në afërsi të shkollave;
6. Montimi i shtyllave kundërparkimi në trotuare dhe sipërfaqe gjelbëruese;
7. Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe zonat rurale, në 7 loto;
8. Trajtimi i qenve endacakë;
9. Furnizimi me drurë dekorativë për qytet dhe mbjellja e tyre sipas planit dinamik, krasitja dhe prerja e drurëve që paraqesin rrezik;
10. Përgatitja e paramasave për projektet e proceduara për tenderim;
11. Hartimi i Programit të punës së KKSb-së për vitin 2016 dhe njoftimi i anëtarëve me këtë program pune;
12. Është hartuar plani vjetor i veprimit, dinamika e punës, raporti vjetor i

*KKSB-së për vitin 2015, si dhe është përgatitur materiali për mbledhjen e parë të KKSB-së për këtë vit;*

- 13. Azhurnimi i vlerësimit të rrezikut për territorin e komunës së Prishtinës për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;*
- 14. Organizimi i kujdestarisë 24 orë pa ndërprerë në Qendrën për Informim, Alarmim dhe Koordinim;*
- 15. Kontrollimi i radiolidhjeve nëpër bashkësitë lokale rurale;*
- 16. Mbajtja e evidencës së hyrje-daljeve të punëtorëve të Komunës në punë, përgatitja e raporteve mujore;*
- 17. Inventarizimi i parkingjeve në disa lagje, rregullimi i komunikacionit në disa pjesë, trajtimin e hapësirave për këmbësorë;*
- 18. Analizat në kuadër të sigurisë në rrugë në afërsi të shkollave dhe Institucioneve;*
- 19. Kontrolli i bartjes së mbeturinave nga ana e ndërmarrjes "Pastrimi".*

**3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

*Të gjitha projektet e lartcekura janë në implementim, sipas kushteve të kontratës dhe planit dinamik.*

- 1. Mbikëqyrja e mirëmbajtjes së ndriçimit publik për vitet 2015-2016, në 3 loto;*
- 2. Mbikëqyrja e mirëmbajtjes së fontanave;*
- 4. Mbikëqyrja e mirëmbajtjes së semaforëve;*
- 5. Mbikëqyrja e montimit të shtyllave kundërparkim në trotuare dhe sipërfaqe Gjelbëruese;*
- 6. Mbikëqyrja e mirëmbajtjes së rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe zonat rurale, në 7 loto;*
- 7. Trajtimi i qenve endacakë*
- 8. Përgatitja e paramasave për projektet e proceduara për tenderim;*
- 9. Fillimi i procesit të mbjelljes së drurëve dekorativë për qytet, si dhe luleve sezonale;*
- 10. Vazhdimi i shpërndarjes së shportave nëpër shkolla për ndarje të mbeturinave;*
- 11. Kontrollimi i radiolidhjeve në bashkësitë lokale rurale;*
- 12. Mbajtja e evidencës së hyrje-daljeve të punëtorëve të Komunës në punë, përgatitja e raporteve mujore;*
- 13. Është përfunduar programi i punës, dinamika e punës, raporti vjetor i KKSB-së për vitin 2015, si dhe është përgatitur materiali për mbledhjen e parë të KKSB-së për këtë vit dhe aktivitetet e Sektorit për mbrojtje dhe shpëtim për vitin 2016;*
- 14. Kujdestaria në QIAK funksionon 24 orë pa ndërprerë;*
- 15. Gjatë këtij muaji, BPZ ka pas 84 intervenime;*

16. QIAK ka pranuar nga qytetarët dhe institucionet e tjera 464 thirrje;
  17. Menaxhimi dhe Mbikëqyrja e kompanive për mirëmbajtjen e rrugëve në sezonin dimëror që janë në realizim e sipër;
  18. Punimi i 9 kartelave për zyrtarët komunalë;
  19. Gjatë këtij muaji nga inspektorët e MSH-së dhe të Preventivës, janë lëshuar 6 njoftime, 11 Konstatime, 7 raporte zjarri, 6 pëlqime, 12 procesverbale me masa.
- Janë krijuar 5.922.90 € të hyra gjatë kësaj periudhe raportuese nga shfrytëzimi i hapësirave publike.

#### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.**

1. Mirëmbajtja e ndriçimit publik për vitin 2015-2016, në 3 loto;
2. Mirëmbajtja e fontanave;
3. Mirëmbajtja e semaforëve;
4. Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe zonat rurale, në 7 loto;
5. Trajtimi i qenve endacakë;
8. Furnizimi me drurë dekorativë për qytet dhe mbjellja e tyre, krasitja e drurëve dhe prerje e atyre që paraqesin rrezik;
9. Mbikëqyrja e projekteve që janë në realizim e sipër;
10. Vazhdimësia e zhvillimit të aktiviteteve në mirëmbajtjen e gjelbërimit nga ana e NPK "Hortikultura";
11. Vazhdimësia e fazës së fundit të zhvillimit të aktiviteteve në projektin "Vendosja e shtyllave kundërparkim dhe shtyllave mbrojtëse të gjelbërimit në qytet";
12. Vazhdimësia e zhvillimit të aktiviteteve në projektin "Zënia dhe trajtimi i qenve endacakë në qytetin e Prishtinës";
13. Vazhdimësia e zhvillimit të aktiviteteve në projektin "Mirëmbajtja e puseve dhe pajisjeve";

##### **4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese**

Në bazë të realizimit të punëve për muajin janar, janë proceduar për pagesë gjithsej 296,940.22 €.

##### **4.1.3 Takimet me palë**

Takimet me palë janë pjesë e procesit të punëve të përditshme, të cilat realizohen në bazë të shqyrtimit të kërkesave, që kanë të bëjnë me:

- Zgjerimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit,
- Problemet e ndryshme që paraqiten në rrugë, hapësira publike, kanalizim, mbeturina etj.;
- Shfrytëzim të hapësirës publike;
- Kërkesa të ndryshme për transport, shenja komunikacioni, parkingje etj.

Gjatë këtij muaji, zyrtaret e Sektorit kanë pas 47 takime me palë.

## **5. Takimet me institucione të tjera**

Takim me MMPH – Divizioni për mbeturina;

Takimi me drejtorin e Shërbimeve Publike nga Obiliqi dhe Graçanica, lidhur me organizimin e transportit ndërkomunal: MPB, MAPL, OSCE, Kryqi i Kuq komunal, UNDP, MPH, GIZ dhe DEMOS.

## **6. Diskutime Publike/Takimet me qytetarë**

- Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur diskutime publike.

### **6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare**

- Gjatë këtij muaji s'ka pasur kërkesa për qasje në dokumente zyrtare.

### **6.1.2 Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.**

- Janë pranuar 170 lëndë gjatë këtij muaji, prej tyre janë realizuar 118, ndërsa 52 janë në realizim e sipër.

### **6.1.3 Takime të tjera**

- Takimet me Kompaninë KUR "Prishtina", KEDS, PTK, IPKO, KFOR, Kryqi i Kuq komunal, ITA (Italian Trade Agency), takim me KFOR-in, organizatën italiane që merret me menaxhimin e emergjencave në nivel lokal, si dhe me DEMOS-in për menaxhimin e SPK-së.

## **7. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.**

Gjatë realizimit të projektit "Vendosja e shtyllave kundërparkim dhe shtyllave mbrojtëse të gjelbërimit", si dhe gjatë realizimit të punëve në mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara në terren, kemi hasur në probleme nga parkimi i automjeteve në vendet ku është dashtë të realizohen punët.

**REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtorëve, furnizim me pajisje shtesë, etj.**

## **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues**

- 1.Mbikëqyrja e realizimit të kontratave të cekura më lart;
- 2.Punimi i projektit për mirëmbajtjen e fontanave dhe krojeve;

3. Riparimi i ashensorëve, faza VIII;
4. Projekti i ndriçimit, varrezave për komunitete;
5. Mbjellja e luleve sezonale dhe drurëve dekorues në qytet;
6. Furnizimi me shporta për ndarje të mbeturinave të riciklueshme në objektet komunale;
7. Furnizimi me kontejnerë 1.1 m<sup>3</sup> dhe kosha 240 l;
8. Riparimi i ashensorëve;
9. Kontrollimi i radiolidhjeve në bashkësitë lokale rurale;
10. Mbajtja e evidencës të hyrje-daljeve të punëtorëve të Komunës në punë, përgatitja e raporteve mujore;
11. Verifikimi i funksionimit të sistemit të alarmimit në qytet;
12. Azhurnimi i planit komunal për mbrojtje nga zjarri;
13. Mbikëqyrja e mirëmbajtjes dimërore të rrugëve;
14. Përgatitja e shënimeve për performancë komunale - komulative të 15 shërbimeve komunale për periudhën 2009-2015, si dhe adresimi në MAPL;
15. Inspektimi i disa nga shkollat e komunës nga aspekti i mbrojtjes;
16. Përfundimi i projektit “Vendosja e shtyllave kundërparkim dhe shtyllave mbrojtëse të gjelbërimit në qytetin e Prishtinës”.

**8. TË TJERA - Shënimi çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.**

Përgatitja për fillimin e rivitalizimit – rregullimit të hapësirave të degraduara gjelbëruese në qytet, sipas planit të përpiluar nga DSHPMSH-ja.